



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 30.06.2021

Prot.38 (tridhjetëetë)

Protokoll nr. 38

I mbajtur sot më datë 30.06.2021, në mbledhjen e radhës të Këshillit të Bashkisë Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00. (online)

1. Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 28.05.2021;
3. P-V “Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin maj 2021”;
4. P-V “Për miratimin e subvencionit të qirasë për familjet e pastreha, të cilat nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për të përballuar vetë gjithë vlerën e qirasë”
5. P-V “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm për vitet 2022-2024”
6. P-V “Për rishikimin e buxhetit të bashkisë Maliq viti 2021”
7. P-V “Për miratimin e kërkesës për transferimin dhe ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të disa pronave nga Ministria e Mbrojtjes të Bashkia Maliq.
8. P-V “Për një shtesë në VKB-në nr.44, datë 11.06.2021 “Për shprehjen e dakortësisë për kërkesën e transferimit të pasurisë nr.1/245, ZK 2573, me sipërfaqe prej 1288 m², e llojit ndërtesë, nga Kombinati i Sheqerti Sh.a Maliq në Ministrinë e Brendshme”;
9. Diskutime të tjera.

Këshilltarë të pranishëm në sallë:

Ornildi Demollari; Pranvera Begolli; File Qyrani; Kujtim Demollari; Floreta Zaçe Evisa Demollari ; Fevri Sherifi ; Klement Zere; Rexhina Hëna; Vasilika Trajko; Dorjan Zholanji; 11(njëmbëdhjetë) këshilltarë

Këshilltarë online në platformën ZOOM: Kristina Malelli; Jonilda Koçllari; Armando Dautllari; Fatjon Brahimllari; Idlir Limllari; Esmeralda Spaho ; Enida Avdoli ; Plator Çollaku; Erisled Jonusllari; 9 (nëntë) këshilltarë.

Të pranishëm nga Administrata: Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu ; Dr. i Shërbimit Social Azem Nuhu; P/Sektorit të Strehimit ; Ledion Mullalli;

Ornildi Demollari: Mirëdita të gjithëve, të nderuar kolegë Këshilltarë i nderuar Kryetar i Bashkisë, fillojmë me mbledhjen e Këshillit të Bashkisë me rend ditë prej 9 pika me të cilat ju jeni njohur paraprakisht. Mbledhja transmetohet prej shumë kohësh edhe on-line, kolegët Këshilltarë po e ndjekin disa on-line, disa janë prezent në sallë, fillimisht miratojmë korumin e mbledhjes, korumi i mbledhjes është, janë 11 Këshilltarë në sallë dhe 9 po na ndjekin on-line, kështu që fillojmë mbledhjen e Këshillit. Miratojmë rendin e ditës? Miratojmë rendin e ditës 1, Hidhet në votim , miratohet rendi i ditës. Në bazë të rregullores të Këshillit duhet të miratojmë dhe protokollin e mbledhjes të kaluar datë 28.05.2021, e miratojmë protokollin e mbledhjes të kaluar? Kush është dakord? kundër, abstenim?, 11 anëtarë votojnë me karton në sallë pro, 9 online pro, Miratohet me 20 vota pro.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ornildi Demollari:Dua tju njoh me Projekt-vendimet e mbledhjes mbledhjes së kaluar të cilat janë bërë vendime dhe kanë marrë dakortësinë e Prefektit të Qarkut të gjithë vendimet.

Vendim “Për miratimin e Ndhmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muaj in prill 2021”;

Vendim “Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë”;

Vendim “Për fillimin e procedurave të zhvendosjes të familjeve që jetojnë pranë ish-Komitetit dhe strehmit të tyre në godinën e ish-Laboradorit qendror si dhe përcaktimin e qirasë për çdo banesë dhe përbërjen familjare”;

Vendim “Për rishikimin e buxhetit të bashkisë viti 2021”;

Vendim “Për miratimin e Raporit të Monitorimit 4-mujor, viti 2021”;

Vendim “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.99, datë 24.12.2021 “Miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të administratës të bashkisë dhe strukturat e saj, për vitin 2021”;

Vendim “Për miratimin e Dokumentit të Vlerësimit të Riskut në Bashkinë Maliq si dhe Strategjinë Operacionale për Zvogëlimin e Riskut nga fatkeqësitë”;

Vendim “Për vendosjen të emrit të shkollës së fshatit Zerec “Shaban Maranaku” (Zereci), shkollës së fshatit Popçisht “Shahin Matraku” dhe vendosjen e bustit në qendër të fshatit Moglicë të “Hasan Bardhit” (Moglica).

Vendim “Për vendosjen të emrit të shkollës së fshatit Rrëmbec “Dhimitraq Gjata”

Vendim “Për miratimin paraprak të Planeve të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave të Bashkisë Maliq”;

Ornildi Demollari:Pika tjetër e rendit të ditës është pika e 3, P-V “Për miratimin e Ndhmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin maj 2021”; Është një pikë që ne kalojmë gjithmonë, ka ndonjë pyetje për këtë?

Floreta Zaçe:Doja të thoja diçka? **Ornildi Demollari:**Po

Floreta Zaçe:Për ndihmën ekonomike do jap një mendim, nuk e di si do kuptohet nga Këshilltarët, unë dua që në çdo lagje ku njerës që marrin ndihmën ekonomike, mund të bëhen aktivitete për të pastruar ambientin para.Është mundësia që të këta njerës të punojnë një ditë në javë.

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu ;Në fakt puna në komunitet ka qënë para disa vitesh pjesë e vendimarrjes që Këshilli i Bashkisë dhe në bashkëpunim me Ministrinë përkatse dhe nismat e qeverisë ata të cilët përfitonin ndihmë ekonomike dhe ishin forca aktive në punë mund të kryenin një punë në komunitet dhe për të justifikuar të themi por edhe për të kontribuar le të themi në projekte që mund të kishte vetë pushteti lokal edhe do ishte pozitive në fakt se të gjithë kemi nevojë atje ku jetojmë për ta mbajtur mjedisin pastër. Por për momentin që flasim kjo nismë nuk funksionin, ndoshta duhet të ketë propozime konkrete të Ministrive që kjo të ketë një ndërtidhurje midis punës konkrete dhe pagesës, ndoshta duke rritur dhe pagesën për ata që do të kontribujnë në komunitet në zonat e tyre për efekt të mbajtjes pastër të mjedisit dhe punë të tjera që mund të ketë NJ.A. Besoj se duhet të jenë nisma të rakorduara me Ministrinë linjës, mund të jetë dhe një propozim edhe i Këshillit por më shumë e Drejorisë që mbulon Shërbimin Social, do ishte një nismë pozitive.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ornildi Demollari:Ka ndonjë pyetje tjetër? E kalojmë në votim P-V nr.3 ? Kush është dakord? Kundra? Abstenim? Miratohet me 11 vota me karton nga Këshilltarët në sallë dhe 9 vota nga Këshilltarët online, Miratohet pika e tretë me 20 vota pro, Faleminderit!

Ornildi Demollari: Pika tjetër e rendit të ditës është pika e 4, P-V “Për miratimin e subvencionit të qirasë për familjet e pastreha, të cilat nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për të përballuar vetë gjithë vlerën e qirasë”, janë tre familje që janë pasqyruar në material.

Pranvera Begolli:Propozoj ta miratojmë P-V sepse është një procedurë që e kemi bërë çdo vit, është e përcaktura për tju dhënë familjeve dhe nuk besoj se do ketë komente të tjera.

Ornildi Demollari:Ne jemi të gatshëm të subvencionojmë dhe familje të tjera, por ka familje që nuk plotësojnë kriteret apo jo? Sepse nuk marrin dot një kontratë qiraje të rregullt? Ka ndonjë pyetje tjetër? E kalojmë në votim P-V nr.4 ? Kush është dakord? Kundra? Abstenim? Miratohet me 11 vota me karton nga Këshilltarët në sallë dhe 9 vota nga Këshilltarët online, Miratohet pika e 4 me 20 vota pro, Faleminderit!

Ornildi Demollari: Pika tjetër e rendit të ditës, P-V “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm për vitet 2022-2024”

Ornildi Demollari:Këtu dua të shoj dhe diçka në bazë dhe të sondazhit që është bërë on-line me publikun, dua tju them se prioritetet e publikut janë pasqyruar në PBA dhe është sjellë këtu nga Institucioni, kështu desha vetëm tju informoja. Kush e do fjalën, ka pyetje?

Pranvera Begolli:Përshëndetje Kryetar! Po të shohim P-V dhe Relacionin shpjegues është i qartë dhe nuk besoj se Këshilltarët të kenë ndonjë problem janë parashikime që janë bërë dhe pastaj çdo vit rast pas rasti do ketë ndryshime, apo jo Kryetar i Bashkisë? Kështu që unë jam ta miratojmë P-V.

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu :Është një procedurë standarte hartimi i buxheteti për vitet 2020-2024, ajo çfarë dua të them unë se kjo ka kaluar më parë në këshillin e Bashkisë, ajo çfarë ju keni miratuar ja kemi çuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, sepse aktet ligjore në fuqi përcaktojnë marrjen e mendimeve, vërejtjeve nga Ministria.Nuk kemi patur asnjë vërtetje, atë që kemi kaluar është në rregull.Kështu që le ti japim miratimin përfundimtar sot për buxhetin afat-mesëm të Bashkisë.

Ornildi Demollari:Faleminderit! Ka pyetje tjetër? Kolegë që po na ndiqni on-line ka ndonjë pyetje?

Idlir Limllari:Kam diçka? **Ornildi Demollari:**Po Idlir

Idlir Limllari:Të shikohet mundësia për tu zvogëluar shpenzimet operative në krahasim me investimet se raporti është 1 me 3, dhe nga viti në vit po rriten shpenzimet operative në krahasim me investimet.

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu :Për sqarim për Këshillin dhe veçanërisht për komunitetin, shpenzimet operative nuk janë shpenzime luksi, por janë shpenzime për shërbime direkte në komunitet, nga lyerja e shkollave, drutë e zjarrit, ndriçimi publik.Atë çfarë ndoshta bashki të tjera e bëjnë ndryshe, duke e bërë prokurim dhe këtë vlerë e futin në investime, ne nuk e bëjmë kështu se duam të përfitojmë sa më shumë fonde, duke përfaur dhe nga mos pagimi i TVSH-së prej 20%. Nëqoftëse do lyesh një shkollë nga një firmë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

private do paguash koston e përgjithshme, fitmin e firmës dhe 20% TVSH. Ajo çfarë ne bëjmë, është një praktikë që e bëjmë ndër vite, është që të gjitha këto i bëjmë me punonjësit tanë, kemi në organikë që të gjithë punonjësit mbulojnë sektorë të veçantë por mora vetëm një element siç është lyjerja, meremetimi apo gjithë investimet që ne kryejmë në shkolla pasi ky është zëri që kap më shumë. Ndaj edhe shpenzimi në pamje të parë duket i madh në shpenzimet operative por janë shpenzime direkte që kanë të bëjnë me komunitetin që nga tubacionet, ndriçimi publik, meremetimi e shkollave etj. Janë investime direkte atje hyn edhe riparimi i rrugëve të fushave, kanaleve të gjitha investimet që kryhen në bashki. Ndaj edhe doja ta bëja shpjegim dhe për Idlirin por veçanërisht për publikun që janë shpenzime direkte në shërbim të qytetarit. A ka vend për ta parë? Ndoshta kjo i takon kur të miratojmë buxhetin faktit të viti 2022 aty zë për zë mund të ketë që shkurtohet një shpenzim operativ kur ju e mendoni që mund të jetë i tillë dhe kalojmë në investim. Por me pak fjalë jemi në të njëjtë linjë me atë që ne kemi menduar për të realizuar në buxhetin e një viti kalendarik. Faleminderit!

Ornildi Demollari: Faleminderit z. Kryetar!

Idlir Limllari: Kujtova se ishin vetëm shpenzime branda bashkisë, në rregul jemi. Faleminderit!

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu: Jo! Po të ishte ashtu do të ishte problem, ato janë lekë që shkojnë në të gjitha shpenzimet që ne kryejmë në terren. Ajo del në buxhet kur ne i miratojmë, faleminderit, edhe shqetësimi është me vend dhe më vjen mirë kur ka Këshilltarë edhe e kam me të gjithë këtë që duan të kuptojnë se çfarë ndodh me paratë dhe Taksat e njerëzve.

Ornildi Demollari: Faleminderit z. Kryetar! Ka pyetje tjetër për pikë 5? E kalojmë në votim? Kush është dakord? Kundra? Abstenim? Miratohet me 11 vota me karton nga Këshilltarët në sallë dhe 9 vota nga Këshilltarët online, Miratohet pika e 5 me 20 vota pro, Faleminderit!

Ornildi Demollari: Dua tju njoftoj që pasi të përfundojmë mbledhjen e Këshillit Bashkiak, do zhvillohet mbledhja e Asamblesë së Përgjithëshme për dy Sh.a Kombinati i Sheqerit dhe Klubi i Futbollit Maliq. Faleminderit! Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës 6, P-V “Për rishikimin e buxhetit të bashkisë Maliq viti 2021”

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu: Mund të jap një sqarim, P-V që ju sjellim është në vazhdim të vendim marrjeve që ka marrë këshilli për rikualifikim të zonës afër lumit Devoll, atje duam të ndërtojmë një lulishte për qytetarët, për të gjitha moshat le të themi nga fëmijet deri të moshuarit. Kjo brenda ka dy elementë, ka edhe rehabilitimin e zonës por dhe për efekt shproznimi të një godine që del atje në cep. Këto dy elementë dhe për efekt të realizimit dhe konfirmimit edhe të gjithë elementve që ka një procedurë, e kanë të detyrueshëm fondin e disponueshëm për ta realizuar. Ndaj dhe ne nga kursimet që kemi bërë në buxheti ne Bashkisë nga prokurimet publike, këto fonde nuk shtojnë Taksa pao Tarfia ekstra për komunitetin. Por janë fonde të kursyera nga ana jonë.

Ornildi Demollari: Kët ofonde nuk shkurtohen në këto zëra, janë kursyer? Punët po realizohen?

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu: Po, punët po realizohen. Sot që po flasim po kryehn punimet për fazën e II në Vloçisht, atje janë kursyer 2.4 milion lekë. Të njëjetën gjë po bëjmë dhe rrijtet e brendëshme të ujësjellsave.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ornildi Demollari:Shumë mirë kjo është për tu lavdëruar.

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu:Pika e 3 se ndoshta ka nevojë për një shpjegim, për bashkëfinancim për familje në nevojë.Nuk është se ne nuk duam ta realizojmë, por Ministria e Financave në programin e këtij viti ka marrë në konsideratë që gjithë findin do mbulojë Ministria e Financave shpresojmë të dalim fitues atje.Duam të realizojmë një projekt si në Pojan por më të madh në NJ.A e tjera.

Ornildi Demollari:Shumë mirë, është e nevojshme se me sa di ka edhe shumë kërkesa. Ka pyetje tjetër?

Pranvera Begolli:po ta shikoni është gjëja më e mirë që mund ti bëhet qytetit, një lulishte dhe një park kur është i domosdoshëm për të gjithë komunitetet, e falenderojmë Kryetarin dhe stafin që ka punuar për këtë.Unë jam të miratohet.

Ornildi Demollari:Kolegë që po na ndiqni on-line? E kalojmë në votim? Kush është dakord? Kundra? Abstenim? Miratohet me 11 vota me karton nga Këshilltarët në sallë dhe 9 vota nga Këshilltarët online, Miratohet pika e 6 me 20 vota pro, Faleminderit! Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës 7, “Për miratimin e kërkesës për transferimin dhe ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të disa pronave nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Maliq.Edhe kjo ishte diçka shumë e pritur prej nesh.

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu:Sa për informacion Këshilltarve, por Këshilltarët e dinë por për komunitetet, ka disa prona që ne ka vite që i kërkojmë që M.M të na i kalojë ne pronesi të Bashkisë Maliq.Janë prona të ushtrisë në teritorin tonë, po ta shikoni te disa ka fillaur degradimi, prona të cilat kur të kishim nevojë nuk do mund ti përdornim më.Ndaj dhe tani kemi marrë ok nga M.M, por që ne ti pranojmë ti bëjmë pjesën tonë është dhe një procedurë ligjore që Këshilli i Bashkisë duhet të japë dakortësinë.Janë prona që ndodhe në zonën e Gorës por edhe në NJ.A Libonik, janë ish-reparte ushtarake, ish-rezerva, depo të cilat mund të na shërbejnë për shumë veprimtari po pse mos themi edhe për ta na sigurojë të ardhura për komunitet dhe Bashkinë tonë.

Ornildi Demollari:Shpresoj që ne të arrijmë të ndalim degradimin pastaj pse jo ti vemë dhe në funksion. Ka pyetje tjetër për këtë? E kalojmë në votim? Kush është dakord? Kundra? Abstenim? Miratohet me 11 vota me karton nga Këshilltarët në sallë dhe 9 vota nga Këshilltarët online, Miratohet pika e 7 me 20 vota pro, Faleminderit! Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës 8, P-V “Për një shtesë në VKB-në nr.44,datë 11.06.2021 “Për shprehjen e dakortësisë për kërkesën e transferimit të pasurisë nr.1/245, ZK 2573, me sipërfaqe prej 1288 m2, e llojit ndërtesë, nga Kombinati i Sheqerti Sh.a Maliq në Ministrinë e Brendshme”;Është fjala për ish-fabrikën e Niseshtesë apo jo?

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu:Ta sqarojmë meqë jemi në komunikim on-line me qytetarët, Këshilli herë e kaluar mori një vendim për kalimin e një pasurie për efekt të Komisarariatit të Policisë që shërbimi ndaj qytetarve të afrohet mos ndodhë në Korçë.Por paralelisht me këtë kërkojnë dhe sipërfaqe ndihmëse funksionale parkingu etj në shërbim të banorve dhe godina të cilën ne kemi kaluar nuk e kishte.Sipërfaqe e tokës është një nr pasurie për gjithë Kombinatin dhe kjo kishte nevojë për një plan rilevimi për një ndarje që të vemë në funksion një sipërfaqe të pramueshme që të jetë në funksion edhe të Komisarariatit por që mos rëndojë edhe pjesën e Bashkisë apo të Sh.a Sheqerit në funksione të domosdoshme në momente të dyta.Prandaj është bërë një plan rilevimi i ri është bërë një ndarje pasurie për zonën që ne mendojmë që do i shërbejë qytetarve, personelit gjithë shërbimet që kryen një



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Komisariat.Në këtë aspekt kemi paraqitur këtë P-V që i shtohet vendimarrjes që kemi bërë një mbledhje më parë dhe kompletojmë komplet si vendimarrje.Dhe të fillojë financimi dhe ai Komsariat të jetë funksional sa më shpjet.

Ornildi Demollari:Kjo është sipërfaqaj funksioanle?

Pranvera Begolli:Duhet të marrim vendim për sipërfaqen funksionale dhe tja bashkangjitem vendimt tjetër.

Ornildi Demollari:Dakord! Ka pyetje tjetër për këtë? E kalojmë në votim? Kush është dakord? Kundra? Abstenim? Miratohet me 11 vota me karton nga Këshilltarët në sallë dhe 9 vota nga Këshilltarët online, Miratohet pika e 7 me 20 vota pro, Faleminderit!Pika e fundit është diskutime të tjera, ka ndonjë gjë? Kisha unë diçka, kemi në fakt dy kërkesa, një kërkesë që është e vjetër për financimin e një botmi nga një studiues që quhet Artan Hoxha i cili ka bërë një material një libër për ish-Kënetën e Maliqit, për tharjen e saj.Ne jemi njohur me kërkesën e studiuesit ai ishte në Maliq dhe jam takuar personalisht me të.Botimi na u duk me shumë vlere, ai pret financimin nga ne, por ne nuk po gjejmë një bazë ligjore për ta financuar këtë.Z.Kryetar në këtë situatë jemi.

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu:Sekretari i Këshillit të rakordojë zyrë Juridike dhe në zyrën Juridike dhe në Prefekturë për të gjetur një modalitet.Unë do isha i mendimit që botimet të cilat e shtojnë arkivën e librave që flasin për zonën tonë do sihte pozitive.Nuk do isha dakord që këtë ta bënim për efekte persoanle të poetve të ndryshëm.Por efekt të librave që japin Historinë e zonës do ishte shumë pozitive, siç mund të jetë është botuar një libër në Kosovë kur bëme konferencën e arkilogjisë Shqipëtare.Ata na dhuraon kopje dhe Anglisht dhe Shqip të botimit për zbulimet Ilire.Po kështu është edhe kjo libër që flet për tharjen Kënetës që në periudhë periudhën Osmane.Jam dakord të këtë dhe libra të tjerë, unë parimisht jam dakord por ajde të gjejmë modalitetet ligjore që çdo gjë të jetë ok.Që ti deryjmë “botuesit” që me këtë vlerë që ne paguajmë ata të pasurojnë bibliotekat tona.Pavarshisht se për momentin e kemi problematikë bibliotekën e qytetit për efekt të djegjes së Pallatit të Kulturës.Kështu mund të jemi të vonuar, nqs biem dakord ta kajojmë parimisht dhe të gjejmë kuadrin ligjor pranë Institucionit të Prefektit.Se nu ke dimë si është modaliteti.Një libër tjetër është dhe për zonën e Zboqërisë, mu duk interesant dhe ai.nuk duhet të hapim lojë për të gjithë poetet që kanë botime.

Ornildi Demollari:E kam me merak këtë pjesë, kërkesa e dytë është mbështetje financiare për mundësinë e një botimi Historiko-Shkencor për zonën e Zboqërisë.

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu:Këshilltarët të njihen dhe këtë kërkesë, por ne duhet të gjejmë pjesën ligjore.Këta nuk po kërkojnë vlere të mëdha flitet për 100 mijë 150 mijë lekë të reja.Botuesi do na verë në dispozicion 20-30 kopje që në një farë mënyre bëjnë ato lekë.ajo çfarë na intereson ne që të kemi disa libra për zonën tonë.Dhe unë i vlersoj këta studiues që kanë shumë informacion për tharjen e Kënetës dhe jo vetëm.

Ornildi Demollari:Të gjejmë bazën ligjore dhe bëjmë gati një P-V dhe ta kalojmë në mbledhje më afërt.Faleminderit!Kjo ishte mbledhja për sot.

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI